

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Shqipe Qerimi, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit I.B., nga fshati ..., Komuna e Gllogocit, për shkak të veprës penale vjedhja, nga neni 325 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit, avokatit S.Z., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Gllogoc, P.nr.364/2018, të datës 24 janar 2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 18 mars 2019, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit, avokatit S.Z., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Gllogoc, P.nr.364/2018 i datës 24 janar 2019, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Gllogoc, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin I.B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja, nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind Euro), të cilën shumë i pandehuri është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, e nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e cekur, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, duke e llogaritur për 1 (një) ditë burgim me 20 € (njëzet Euro). E nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të dënimit me gjobë, atëherë ekzekutimi i dënimit do të ndërpritet.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, apo nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mundet me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë, me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme, llogariten me 20 € (njëzet Euro) gjobë. Gjithashtu, ndaj të pandehurit I.B., gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar edhe dënim me kusht, ashtu që të pandehurit i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe në të njëjtën kohë është urdhëruar që ky dënim të mos ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vjetëve, nuk kryen vepër tjetër penale.

Të pandehurit I.B., i është hequr masa e paraburgimit, pasi që kanë pushuar shkaqet e caktimit të paraburgimit dhe i njëjti menjëherë është liruar nga paraburgimi nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë me datën 24 janar 2019.

Të pandehurit I.B., në bazë të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK, koha e kaluar në paraburgim prej datës 31 dhjetor 2018 deri me datën 24 janar 2019, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

I dëmtuari B.I., lidhur me kërkesën pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt civil.

Është detyruar i pandehuri I.B., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumë prej 30 € (tridhjetë Euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të pandehurit, avokati S.Z., për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën ta aprovoj si të bazuar, ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, duke i shqiptuar dënime më të buta apo ndaj të pandehurit të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.194/2019, të datës 22 shkurt 2019, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit, ndërsa të vërtetohet aktgjykimin i ankimuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit, avokatit S.Z., theksohet se vendimi i gjykatës së shkallës së parë, sa i përket dënimit të shqiptuar me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind Euro), është dënim i rëndë, duke pasur parasysh faktin se i pandehuri ka një gjendje tejet të rëndë si në aspektin shëndetësor, ashtu dhe në atë material, sepse i njëjti jeton në kushte të vështira ekonomike, është mbajtës i familjes, është person me dëmtim të shëndetit fizik, me plagë të dukshme në kokë, këmbë dhe duar, përveç kësaj i njëjti është përdorues i alkoolit dhe duhanit, gjë që e përkeqëson edhe më tepër gjendjen e tij shëndetësore. Duke jetuar në kushte të vështira ekonomike, i pandehuri e ka të pamundur që të paguaj një shumë të tillë në vlerë prej 500 € (pesëqind Euro) të dënimit me gjobë. Në anën tjetër, dërgimi i të pandehurit në burg për shkak të pamundësisë së pagesës së dënimit me gjobë, do t'ia dëmtonte edhe më shumë shëndetin e tij. Andaj, duke bazuar në këto rrethana, mbrojtësi i të pandehurit i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar.

Sa i përket dënimit të shqiptuar, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, siç parashihet në nenet 74 deri 76 të KPRK. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit kishte marrë për bazë këto rrethana lehtësuese për të pandehurin I.B. : i njëjti kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale, se kishte premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, se është pënduar për kryerjen e veprës penale, se kishte kërkuar falje, se është i martuar dhe mbajtës i familjes, se është babë i një fëmije të moshës tre vjeçare dhe ka gjendje të dobët ekonomike, ndërsa rrethana rënduese ka gjetur shkallën e lartë të dashjes së personit. Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë dhe rrethanat tjera të rastit konkret, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit I.B., nga ana e gjykatës së shkallës së parë është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me gjendjen ekonomike të të pandehurit. Gjithashtu, Gjykata e Apelit e Kosovës është e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
Departamenti i Përgjithshëm  
PA1.nr.174/2019, më datën 18 mars 2019

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Kimete Veseli

\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:  
Afrim Shala

\_\_\_\_\_

Shqipe Qerimi

\_\_\_\_\_

Kryetari i kolegjit,  
Gani Zabeli

\_\_\_\_\_